

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

*Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Një ankesë kundër: **MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **201-25-10899-2-2-1**

Sa i përket tenderit për **Kontraktor Individual për Shërbime të veçanta- punëtor social për ofrimin e shërbimeve në Komisionin Vlerësues Mediko-Social për vlerësimin e shkallës së verbërisë në Komisionin Mediko-Social**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	<b>VALDETE SADRIJI</b>
NUI	<b>602427727</b>
Adresa	<b>Ulpiane , Soliteri 5 C/1 , Prishtine</b>
Vendi	<b>Prishtine</b>
Kodi postar	<b>10000</b>
Numri Telefonit	<b>+383/44/412367</b>
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	<b>Valdete Sadriu</b>
Adresa elektronike	<b>valdetesadriu2@gmail.com</b>
Data e parashtrimit të ankesës	<b>10.04.2026</b>

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

#### 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

Emri i avokatit  
Adresa e plotë  
Numri i Telefonit  
Numri i faks-it  
Adresa elektronike

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:*

Ankesa i përket grupeve:

**Kontraktor Individual për Shërbime të veçanta- punëtor social për ofrimin e shërbimeve në Komisionin Vlerësues Mediko-Social për vlerësimin e shkallës së verbërisë në Komisionin Mediko-Social”**

1. Njoftimi për kontrate: 03.12.2025
2. Afati për dorëzim të tenderit: 22.12.2025
3. Procesverbali i hapjes së Ofertave: 22.12.2025
4. Kriteri i vlerësimit të ofertave : Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm;
5. Aneksi 4: KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË: 09.12.2025
6. Përgjigjja – Sqarimit e Autoritetit Kontraktues: 15.12.2025
7. Formulari B58- Njoftimi për dhënie të kontratës/vendimi i AK : 20.01.2025
8. Letër Standarde për Tenderuesin e Eliminuar: 20.01.2026
9. Kërkesë për lejimin e qasjes në dokumentet e tenderit, dërguar të Autoriteti Kontraktues për mes platformës së E-Prokurimit: 20.01.2026
10. Konfirmim i Autoritetit Kontraktues për të na lejuar qasje në dokumentet e Tenderit: 21.01.2026
11. Kërkesa për Rishqyrtim: 26.01.2026
12. Vendimi i AK për aprovim të pjesshëm të Kërkesës për Rishqyrtim: 02.02.2026
13. Ankesa nr.2026/0081 e datës 06.02.2026
14. Kërkesë nga AK për vazhdim të validitetit të ofertës:18.02.2026
15. Konfirmimi i vazhimit të validitetit të ofertës: 18.02.2026
16. Raporti i Ekspertit Shqyrtues 2026/0081: 24.02.2026
17. Vendimi i Panelit Shqyrtues Nr. OSHP: 2026/0081 i datës 13.03.2026
18. Formulari B58- Njoftimi për dhënie të kontratës/vendimi i AK për anulim të aktivitetit të prokurimit : 23.03.2026
19. Letër Standarde për Tenderuesin e Eliminuar: 23.03.2026
20. Kërkesë për lejimin e qasjes në dokumentet e tenderit, dërguar të Autoriteti Kontraktues për mes platformës së E-Prokurimit: 24.03.2026
21. Autoritetit Kontraktues me datën 25.03.2026 përmes platformës së e-prokurimit të Letrat Standarde na ka dërguar Raportin e Rivlerësimit të ofertave të datës 19.03.2026
22. Kërkesa për Rishqyrtim: 27.03.2026
23. Vendimi i AK për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim: 31.03.2026

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

##### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

##### 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

**Me datën 27.03.2026 përmes platformës së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për Rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues. Me datën 31.03.2026 përmes platformës së E-prokurimit kemi pranuar përgjigjeje – Vendimin nga Autoriteti Kontraktues për refuzim si të pa bazuar të Kërkesën për Rishqyrtim.**

##### 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

**Shkeljet e dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92, (LPP), janë:**

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit;

**Shkeljet e dispozitave - Rregullores 002/2024 për Prokurimin Publik (RRPP 002/2024), janë:**

Neni 40 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;

Neni 43- Ndërprerja e procedurave të prokurimit;

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

Autoriteti Kontraktues – ADMINISTRATA E QENDRËS - MINISTRIA E FINANCAVE,PUNËS DHE TRANSFEREVE pas vendimit të Panelit Shqyrtues Nr. **OSHP: 2026/0081** të datës **13.03.2026** ka bere ri vlerësimin e ofertave dhe me datën **23.03.2026** në Platformën e E-Prokurimit ka bere publikimin e Formularit B58-Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Këtij Vendimi AK ja ka bashkangjitur Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar.

Autoriteti Kontraktues në Formularin B58- Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ka shënuar:

“Ministria e Financave anulon këtë aktivitet të prokurimit”

Me datën 24.03.2026 kemi bere kërkesë për qasje në dokumente e tenderit dhe Autoriteti Kontraktues dhe AK me datën **25.03.2026** përmes platformës së E-Prokurimit na ka dërguar Raportin e Ri-vlerësimi të ofertave të datës **19.03.2026** të aprovuar nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me datën **23.03.2026**.

### **Pretendimi ankimore 1- Shkelje e nenit 59 të LPP si dhe shkelje e nenit 40 të RRPP NR.002/2024.**

Bazuar në dokumentet që kemi shkarkuar nga Platforma e E-prokurimit, dokumentet që kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues dhe dokumentet që kemi dorëzuar së bashku me ofertën dëshmohet së Komisioni i Ri-Vlerësimit të ofertave, **ri vlerësimin e ofertës time** e ka bere në kundërshtim të plote me **nenin 59 të LPP** dhe **nenit 40 të RRPP 002/2024** për Prokurim Publik.

#### **Faktet dhe argumentet së pse unë konsideroj kështu janë:**

Në Letrën Standarde për Tenderuesin e Eliminuar që ka të beje me ofertën time, si arsyetim të eliminimit të ofertës time ka shënuar, **citoi:**

“ Në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontrate është kërkuar Diplomë e arsimit të larte e nivelit pare (Bachelor), në Sociologji, Politikat Sociale dhe Mirëqenie, ndërsa VALDETE SADRIJI ka dorëzuar diplomën Master I Arkivistës, master në politike sociale dhe mirqenje të fëmijëve dhe diplomën ne bachelor të Psikologjisë, por jo si është kërkuar ne dosje dhe ne njoftim për kontratë siq ka vendosur edhe Paneli shqyrtues në vendimin me nr. OSHP:2026/0081 të datës 13.03.2026”, **përfundim i citatit.**

Ky argument i komisionit të Ri vlerësimit të ofertave **nuk qëndron për faktin** së pas shkarkimit të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontrate nga platforma e e-prokurimit kemi vërejtur së Autoriteti Kontraktues ka vendosur kritere diskriminuese dhe favorizuese për kandidat të caktuar. Unë Valdete Sadriji me datën **09.12.2025** përmes Platformës së E-Prokurimit kam dërguar të AK , **Aneksin nr. 4** të Dosjes së Tenderit: **KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË**, ku në këtë aneks përveç tjerash kam kërkuar sqarime lidhur me **kërkesën numër 1**, pikën III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional. **Dëshmi 1 – Aneksi nr.4- KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË e datës 09.12.2025**

Autoriteti Kontraktues me datën **15.12.2025**, në Platformën e E-Prokurimit ka publikuar Përgjigjet në Pyetjen tone dhe në këtë përgjigje përveç tjerash ka shënuar, **citojmë** : Kërkesa e përshtatshmërisë profesionale e shprehur në “Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), në Sociologji, Politikat Sociale dhe Mirëqenie.” Nënkupton se ofertuesit duhet të kenë së paku diplomën e kërkuar të nivelit Bachelor, kurse ofrimi i diplomave Master apo edhe Doktoraturë **po ashtu do të plotësonte kushtin e kërkuar, me kushte që diploma e nivelit Bachelor të jete po ashtu e vendosur në dosjen ofertuese. Si rrjedhoje, diploma e kërkuar e Bachelor-it nuk është kusht përjashtues por është minimumi që kërkohet në ofertim. “ Dëshmi 2 – Sqarimet e publikuara nga AK ne Platformën e E-Prokurimit me datën 15.12.2025.**

Nga ky sqarim që ka publikuar AK në platformën e e-prokurimit me datën **15.12.2025** shume qarte shihet së AK ka bere ndryshimin e kriterit dhe ju ka dhëne mundësi të gjithë kandidateve të interesuar që të ofertojnë edhe me “diploma Master apo edhe Doktoraturë” dhe gjithashtu në sqarim ka shënuar së “ **Si rrjedhoje diploma e kërkuar e Bachelor-it nuk është kusht përjashtues por është minimumi që kërkohet në ofertim.**“

**Duke u bazuar në sqarimet ( ndryshimin e kriterit) që AK që ka publikuar me datën 15.12.2025**, unë Valdete Sadriji për ta plotësuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues të Kapacitetit Teknik dhe Profesional- Kërkesa nr. 1, së bashku me ofertën kame dorëzuar Diplomën Master (MA) në Politika Sociale dhe Mirëqenia e Fëmijëve të lëshuar nga Kolegji AAB me datën **03.08.2017** , program i akredituar nga Agjencia Kosovare për Akreditim. **Dëshmi 3 – Diploma Master (MA) e lëshuar nga Kolegji AAB me datën 03.08.2017**

Gjithashtu së bashku me ofertën kam dorëzuar edhe - Diplome - Bachelor i Psikologjise të lëshuar nga Universiteti “Hasan Prishtina”- Fakulteti Filozofik në Prishtinë me datën **10.07.2013**- program i akredituar nga Agjencia Kosovare për Akreditim. **Dëshmi 4 – Diploma Bachelor i Psikologjise të lëshuar nga Universiteti “Hasan Prishtina” - Fakulteti Filozofik me datën 03.08.2017**

Bazuar në legjislacionin që rregullon fushën e Arsimit të lartë në Republike e Kosovës dhe bazuar në sqarimet e publikuara nga Autoriteti Kontraktues platformën e e-Prokurimit me datën **15.12.2025**, **Diploma Master (MA) e lëshuar nga Kolegji AAB me datën 03.08.2017** që unë kam dorëzuar së bashku më ofertë jo vetëm që e plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues **por edhe e tejkalon** për faktin së kemi të bëjmë me angazhim të një konsulenti/je për kryerje të shërbimeve dhe përgatitja profesionale-Grada Master (MA) çdo here **vlerësohet me lartë** në raport më përgatitjen profesionale-**Bachelor**.

Nga të dhënat e shënuara në **Raportin e Ri-vlerësimit të ofertave të datës 19.03.2026** shume qarte shihet së Komisioni i Ri-vlerësimit të ofertave çdo here ju ka referuar kriterit- Kërkesës 1 të Kapacitetit Teknik profesional **siç ka qene në Dosje të Tenderit dhe Njoftimit për Kontrate**. Ky fakt dëshmon së komisioni i Ri vlerësimit të ofertave nuk ka **marre për baze fare sqarimet që AK ka publikuar në platformën e E-Prokurimit me datën 25.12.2025**.

**Ketë e dëshmojnë këto të dhënat të shënuara në Raportin e Rivlerësimit të Ofertave:**

Në faqen nr. 6 të Raportit të Lista e Plote Standarde për Përshtatshmërinë e Aftësive Profesionale të Tenderëve ka shënuar:

**“1.Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), në Sociologji, Politikat Sociale dhe Mirëqenie. .”**

**Po në faqen 6 të Raportit të Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me aftësitë teknike dhe / ose profesionale, ka shënuar:**

**“Është Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), në Sociologji, Politikat Sociale dhe Mirëqenie. Ndërsa VALDESTE SADRIJI nuk e ka dëshmuar”**

**Në faqen nr. 8 të Raportit të DEKLARATAË, ka shënuar:**

**“ Tenderuesja Valdete Sadriji ka dështuar të dëshmoje se posedon diplomë të arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor), në Sociologji, Politikat Sociale dhe Mirëqenie, pasi që e njëjta posedon Diplome (Bachelor), të Psikologjisë, pra e njëjta nuk e ka diplomën sipas kriterit të dosjes së tenderit, përkatësisht nuk i ka plotësuar kërkesat e përshtatshmërisë.”**

Këto të dhëna të shënuara në Raportin e Ri-vlerësimit të ofertave të datës **19.03.2026** me së miri e dëshmojnë së Komisioni i Rivlerësimit të ofertave **fare nuk i ka marre për baze sqarimet që vete AK i ka publikuar në platformën e e-prokurimit me datën 15.12.2025** ku siç e cekem edhe me lartë vete AK përmes sqarimeve ju ka dhënë mundësi të gjithë kandidateve të interesuar që të ofertojnë edhe me diploma Master apo edhe Doktoraturë dhe së **diploma e kërkuar e Bachelor-it nuk është kusht përjashtues por është minimumi që kërkohet në ofertim.**“

**Prandaj shtrohet pyetja: Si ka mundësi që vete AK përmes sqarimeve të ju mundësojë kandidateve që të ofertojnë me “Diplomë Master apo edhe Doktoraturë” dhe vete AK ka konfirmuar së “diploma e kërkuar e Bachelor-it nuk është kusht përjashtues por është minimumi që kërkohet në ofertim”,** ndërsa Komisioni i Ri vlerësimit të ofertave **mos ti marre për baze** fare këto sqarime të publikuara nga vete AK dhe Diplomën time Master (MA) e lëshuar nga Kolegji AAB me datën 03.08.2017 të konsiderojë së nuk i përmbushë kërkesën e AK?

Ajo çka është ma skandaloze dhe tendencioze nga komisioni i ri-vlerësimit të ofertave është fakti së komisioni i Ri vlerësimit të ofertave në raportin e Ri vlerësimit të ofertave, qëllimisht ka shënuar: “ “VALDETE SADRIJI ka dorëzuar diplomën Master I Arkivistës, master në politike sociale dhe mirqenje të fëmijëve.....”. Bazuar në këtë përshtkrim që ka bere komisioni i rivlerësimit të ofertave shihet së komisioni qëllimisht diplomën time Master i Arkivistës e shënon si të paren me qellim të manipulimit së gjeja unë këtë diplomë e kam dërguar për ta plotësuar kriterin e kërkuar nga AK dhe bazuar në këtë diplomë unë nuk e plotësoje kriterin e kërkuar nga AK. Ndërsa realiteti është krejt tjetër për faktin së unë Master I Arkivistës e kam dërguar së bashku me ofertën vetëm për ta dëshmuar kapacitetet e mia profesionale edhe në lëmi tjera çka konsiderojë së është dashur të konsiderohet si përparësi e jo si diskriminuese.

Këto veprime të Komisionit të Ri vlerësimit të ofertave që cekem me lartë me së miri e shpërfaqin jo profesionalizim dhe tendencën që me çdo kusht të me eliminojnë nga aktiviteti i prokurimit.

Unë konsideroj së këto veprime të Komisionit të Ri Vlerësimit të ofertave janë të motivuara edhe nga fakti së kandidateve e preferuar nga Njësia e Kërkesës, Komisioni i Vlerësimit të pare të ofertave dhe tani edhe nga Komisioni i Ri-vlerësimit të ofertave, bazuar në Ankesën time nr.2026/0081 të datës 06.02.2026 dhe Vendimit të Panelit Shqyrtues **Nr. OSHP: 2026/0081** të datës **13.03.2026** është konstatuar së oferta e kandidates së preferuar as për së afërmi nuk i plotëson kriteret e kërkuara nga vete AK dhe së komisionit të Ri vlerësimit të ofertave ju ka pa mundësuar që me kontrate të shpërblejnë prape këtë kandidate.

Për ta dëshmuar profesionalizmin tim dhe kapacitetet e mia profesionale unë përveç Diplomës Master (MA) në Politika Sociale dhe Mirëqenia e Fëmijëve të lëshuar nga

Koligji AAB dhe Diplomës - Bachelor i Psikologjise të lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina"- së bashku me ofertën kam dorëzuar edhe këto dokumente:

**Vendimin e datës 30.10.2025** për Miratimin e Temës për Studimet Master në Universitetin e Tetovës -Fakulteti Filozofik Programi Studimor – Psikologjia Klinike dhe Këshilluese- Titulli i Temës: **“Mirëqenia psikologjike, mbështetja institucionale dhe familjare, vetëvlerësimi dhe rregullimi emocional i personave me aftësi të kufizuara në Kosovë”**. Mentor: Prof.Dr. Musa Musai.

**Licencën Profesionist e Shërbimeve Sociale dhe Familjare me nr. 0534** –të datës **16.10.2025** me validitet deri me datën **15.10.2028** të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë – Këshilli Profesional i Shërbimeve Sociale dhe Familjare se bashku me Vendimin e Licencimit të datës 16.10.2025.

**Certifikatë Licencimi për Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare** të lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me datën 25.03.2019;

Certifikatë Licencimi për Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Nivel Profesional të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë me datën **30.08.2023**;

**Diplome- Master i Arkivistikës** të lëshuar nga Universiteti "Hasan Prishtina"- Fakulteti Filozofik në Prishtinë me datën 30.10.2023;

**Disa Certifikata** që dëshmojnë pjesëmarrjen time në trajnime dhe kurse të gjuhës angleze.

**-Dokumente** që dëshmojnë që unë menaxhoj projekte që kane të bëjnë me shërbime sociale.

**Për informimin e Ekspertit Shqyrtues dhe Panelin Shqyrtues :**

Ministria e Drejtësisë – Këshilli Profesional i Shërbimeve Sociale dhe Familjare **diplomën time të Masterit (MA) në Politika Sociale dhe Mirëqenia e Fëmijëve** të lëshuar nga Kolegji AAB me datën 03.08.2017 e ka konsideruar si valide dhe bazuar në këtë diplomë edhe me ka Licencuar për **Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare. Prandaj si ka mundësi që një Institucion kaq kredibil dhe që është i mandatuar për licencimin e Eksperteve Profesional për Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare ta konsideroi se është dëshmi valide** ndërsa Komisioni i Ri-Vlerësimit të ofertave i Autoritetit Kontraktues **ta konsideroj si jo valide?**

Unë **Valdete Sadriji** jam e licencuar për të **treten here radhazi nga Ministria e Drejtësisë – Këshilli i Përgjithshëm i Shërbimeve Sociale dhe Familjare (Licenca nr. 543/25, e datës 16.10.2025 e vlefshme deri më 15.10.2028.** Kjo licencë është dëshmi ligjore së unë kam kaluar procesin zyrtar të vlerësimit dhe jam e autorizuar për **ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në nivel profesional.** Kjo dëshmon jo vetëm përgatitjen akademike, por edhe kompetencën dhe të drejtën time ligjore për ushtrimin e profesionit- **Ofrimin e Shërbimeve Sociale dhe Familjare. Dëshmi 5 – Licenca nr. 543/25, e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë me datën 16.10.2025.**

**Prandaj bazuar në të gjitha këto fakte dhe argumente që cekem me larte shihet së Komisioni i Ri Vlerësimit, vlerësimin e ofertave e kane bere në kundërshtim të plote me nenin 59 të LPP dhe nenin 40 Rregullores 002/2024 për Prokurimin Publik (RRPP 002/2024**

**Pretendimi ankimore 2 - Shkelje e nenit 62 të LPP si dhe shkelje e nenit 43 të RRPP NR.002/2024.**

**Komisioni i Rivlerësimit të ofertave rekomandimin për anulim të aktivitetit të prokurimit e kane marre në kundërshtim të plote më nenin 62 të LPP si dhe nenin 43 të RRPP NR.002/2024.**

**Gjithashtu edhe Zyrtaret e AK Vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit e kane marre në kundërshtim të plote më nenin 62 të LPP si dhe nenin 43 të RRPP NR.002/2024.**

**Arsyet pse unë konsideroj kështu janë:**

Bazuar ne të dhënat e shënuara me larte në këtë ankese shihet së oferta ime – Kandidates-Valdete Sadriji, është oferte e përgjegjshme, i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues, është oferta me çmimin me të lire me vetëm **6,000.00 €**, prandaj Autoriteti Kontraktues nuk ka pasur asnjë bazë ligjore për anulim të aktivitetit të prokurimit.

**Së oferta ime është oferte e përgjegjshme e ka konstatuar edhe Paneli Shqyrtues kur ka nxjerre vendimin me numër OSHP:0206/0081 të datës 13.03.2026 ku lenden e ka kthyer ne Ri vlerësim.**

**Në faqen 1 të këtij vendimi përveç tjerash shënon:**

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE VALDETE SADRIJI me nr. 2026/0081, e datës 06.02.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Kontraktor Individual për Shërbime të veçanta punëtor social për ofrimin e shërbimeve në Komisionin Vlerësues Mediko-Social për vlerësimin e shkallës së verbërisë në Komisionin Mediko-Social” me numër të prokurimit 201-25-10899-2- 2-1.

**Në faqen 14 të këtij vendimi përveç tjerash shënon:**

***Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues **nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit.** Paneli Shqyrtues e **mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues** që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

-

**Bazuar në të gjitha këto fakte dhe argumente që i cekem me larte dhe bazuar në dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar të prokurimit publik të cekura me larte, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, që Ankesën time ta konsideroje si të bazuar, të anuloj Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit të datës 23.03.2026 dhe lenden ta ktheje në Ri-vlerësim**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Unë jam dëmtuar për shpenzimet e bëra me rastin e përgatitjes së Ofertës, përgatitjes së dy Kërkesave për Ri shqyrtim, shpenzimet e përgatitjes së dy Ankesave për OSHP dhe fitimin e kontratës.**

#### **10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*